



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 241, datë 02.12.2021

MBI

LICENCIMIN E SHOQËRISË “ALBESP TRADING & CONSULTING” SH.P.K.,  
NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “d”, nenit 5, pika 1, gërma “d” dhe nenit 13, të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, të ndryshuar, si dhe nenit 15, të “Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 02.12.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 145/4 prot., datë 25.11.2021, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

**Konstatohet se:**

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 226, datë 09.11.2021, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5 vjeçar.
- ERE me shkresën nr. 6/23 prot., datë 10.11.2021, bëri njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët, nuk rezultoi të ketë të tilla.
- Shoqëria me shkresat nr. 1021/2 prot., dhe nr. 10.21/3 prot., datë 15.11.2021, ka përcjellë në ERE dokumentacion dhe informacion mbi aplikimin.
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për tu pajisur me licencë në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike nga ERE, në zbatim të Aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”.

- Dokumentacioni i këtij aplikimi është i plotësuar në zbatim të kërkesave të “Rregullores për Proçedurat dhe Afatet për Dhënie, Modifikimin, Transferimin, Rinovimi ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, si më poshtë:
  - Formati dhe dokumentacioni për aplikim; neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b” dhe “c”. **Plotësuar.**
  - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor; neni 9, pika 3, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”. **Plotësuar;**
  - Dokumentacioni financiar dhe fiskal; neni 9, pika 3, gërma “a”, “b”, “c”, “d”. **Plotësuar;**
  - Dokumentacioni teknik për aktivitetin furnizimit të energjisë elektrike; neni 9 pika 4.7 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “f”, “h”. **Plotësuar.**

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit, që ka të bëjë me:

**Dokumentacioni Teknik për Aktivitetin e Furnizimit të Energjisë Elektrike.**

neni 9 , pika 4.7,

- gërma **“e”**: (Sistemin IT të krijuar për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike apo marrëveshje me të tretët për vënien në dispozicion/përdorimin e këtij shërbimi) Duke qenë se shoqëria është në proces për krijimin e sistemit IT, vlerësojmë që t’i lihet kusht shoqërisë depozitimi në ERE i Sistemit IT, me fillimin e operimit.
- **gërma “g”**: (Dokumentacion që vërteton aftësinë e disponimit të zyrave përfaqësuese të furnizuesit, për shërbimet që do t’i ofrohen klientëve.)
- Shoqëria ka përcjellë në ERE Kontratë Qiraje (kontratë nënqiraje), objekti i saj është dhënia me nënqira tek shoqëria “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k. e një sipërfaqeje për zyra. Sipas dispozitave të kontratës, afati i saj ka filluar në datën 21.10.2021 dhe do të përfundojë në datën 20.09.2024, ndaj duke qenë se kjo nuk mbulon të gjithë periudhën e licencimit, vlerësohet që t’i lihet kusht shoqërisë që të depozitojë në ERE kontratën e qirasë së zyrave që disponon, jo më vonë se 1 (një muaj) pas rinovimit të saj.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

**Vendosi :**

1. Të licencojë shoqërinë “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5 vjeçar.
2. Me fillimin e operimit, shoqëria “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k. të depozitojë në ERE sistemin IT.
3. Shoqëria “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k. të depozitojë në ERE kontratën e qirasë së zyrave që disponon, jo më vonë se 1 (një) muaj pas rinovimit të saj (afati i përfundimit data 20.09.2024).
4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**